

Data 25.01.2025

AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

"BOTA E BIMEVE MEDICINALE " SH.P.K.

- **Z.Arber Beshiku**, i datëlindjes 30.10.1985, i lindur në Tepelen dhe banues në Tirane, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikua ranga pasaporta me nr. **I51030028N**, me nr.telefoni 069 51 33 258.

Të cilët mbështetur në Ligjin Nr.9901 dt. 14/04/2008, "Për shoqëritë Tregtare" dhe në Legjislacionin shqiptar në përgjithesi, kanë vendosur si më poshtë:

Emërtimi, Selia dhe afati i Shoqërisë

Neni 1

Të themelojë shoqërinë me përgjegjësi tëkuifizuar, për të zhvilluar veprimtari private. Shoqëria është person juridik Shqiptar, Veprimatria e të cilës rregullohet nga kjo kontratë, Statuti i saj dhe Legjislacioni në fuqi.

Neni 2

Shoqëria do të emërtohet "**BOTA E BIMEVE MEDICINALE**" Sh.p.k

Neni 3

Selia e Shoqërisë "**BOTA E BIMEVE MEDICINALE**" Sh.p.k. do të jetë në Vore GJOKAJ Fshati Gjokaj, Rruja Gjokaj, ndertese private 1 kateshe, zona kadastrale 2726, me nr.pasurie 15. Tirane
Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

Neni 4

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj me afat të pakufizuar. Ky afat mund të zgjatet ose të shkurtohet me vendim asamblesë së ortakëve.

Shoqëria "**BOTA E BIMEVE MEDICINALE**" Sh.p.k. gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në regjistrin e QKB-së.



Neni 5

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**BOTA E BIMEVE MEDICINALE**” Sh.p.k do të jetë:

Tregtim I bimeve medicinale.

Neni 6

Shoqëria ushton aktivitetin e saj mbi bazë dege në qytete të tjera të vendit, të cilat do të hapen pasi të ketë filluar aktiviteti i shoqërisë.

Neni 7

Selia e shoqërisë mund të transferohet.

Neni 8

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyhen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave i përfitojnë ortakët e saj.

Ortakët themelues përballojnë humbjet e shoqërisë deri në kusfirin e vlerës së tij të derdhur në formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund të ritet nga fitimi në natyrë, ose kredi në lekë ose valutë qe merret në Bankat e Shtetit Shqiptarë. Kapitali Themeltar për vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë është në shumën **3,000,000 Lekë**, që i takon ortakëve themelues.

Ortakët pas zbritjes së taksave do t'i ndahen si vijon:

- Fondi Rezervë
- Shpërblimi që i takon ortakëve themelues në masën 100%.

Neni 9

Shoqëria mund të hyjë në veprimitari të përbashkëta me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja.

Neni 10

Veprimtaria e Shqërisë mund të ushtrohet duke krijuar filial ose përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, në konformitet me Ligjin Shqiptar ose të huaj.

**Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve
Ortakët gëzojnë këto të drejta kryesore**

Neni 11



- Administrimin e veprimtarisë në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Pjesemarrjen në rezultatet e cdo forme dhe sasie të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga mbledhja e përgjithshme e Asamblesë dhe organet e tjera të shoqërisë.
- Të heqë dorë nga shoqëria, heqja dorë nga shoqëria nuk I liron ortakët nga detyrimet financiare të marra më pare ndaj shoqërisë.
- Të marrë pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesit të tij ose vetë.
- Të emërojë dhe të shkarkojnë përfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

Ortakët kanë këto detyrime kryesore:

- Të depozitojnë kuotën e tyre dhe kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vetë ata.
- Ti japë Shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin e cdo objekti të vecantë lidhur me veprimtarinë e saj.
- Të kryejë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.
- Ka detyrimin nëse heqin dorë nga shoqëria ti njoftojnë vendimin e tij asamblesë 6 muaj përpëra dhe duke ceduar të drejtë e zgjedhjes sipas nenit.
- Ti japi shoqërisë informata e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
- Të Kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.

Administrimi

Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

Neni 12

ADMINISTRATORI

Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj i Përgjithshëm. Në Shoqërinë **“BOTA E BIMEVE MEDICINALE” Sh.p.k**, Administrator i Shoqërisë do të jetë Z. **Arbër Beshiku** e cili në të njëjtën kohë ka edhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretët në të gjithë veprimtarinë e tij. Me miratimin e ortakëve mund të emërohen administrator dhe përfaqësues të shoqërisë **“BOTA E BIMEVE MEDICINALE” Sh.p.k**

Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej pesë vjetësh finaciare me përjashtim të rasteve të dorheqjes ose shkarkimit të parakohshëm. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet me interest të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimitarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statusit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.

Mbyllja e Shoqërisë:

Neni 13

Veprimitaria e shoqërisë pushon me propozimin e bërë nga ortakët, kur gjatë dy vjetëve nuk rezulton rentable si dhe të gjitha rastet që parashikohen në dokumentet e krijimit të shoqërisë (kontrata). Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likuidimi.

Kur shoqëria likuidohet:

Neni 14

Asambleja e ortakutëve emëron likujdatorin, dhe shoqëria i jep fund veprimitarisë së saj në castin e miratimit të këtij bilanci të likujdimit. Komisioni I Likujdimit përbëhet nganjë ose tre anetarë. Pasuritë që janë venë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfytëzimi, shiten në vartësi të shkallës së konsumit të tyre. Mjetet finaciare të fituara si rezultat i veprimitarisë së shoqërisë e të filialeve të saj dhe fondevë finaciare ndahen ndërmjet ortakëve në përputhje në përpjestim me kuotat e vëna, pasi të janë bërë pagesat për kreditorët.

Neni 15

Kur pushon Veprimitaria e një filiali, përfekte të riorganizimit të tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Përgjithsme e ortakut.

Likujdimi i filialeve bëhet njësoj si për shoqërinë. Mjetet finaciare vihen në dispozicion të shoqërisë pasi tu janë bërë pagesat likujditorëve.

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

Z. Arbër Beshiku

ARBËR BESHIKU
